

URDHËR
Nr. 465, datë 1.9.2026

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË MARRËVESHJES PËR TRANSFERIMIN E MATERIALIT GJENETIK NGA BURIMET *EX-SITU*

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 44/10, të ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit të marrëveshjes për transferimin e materialit gjenetik nga burimet *ex-situ*, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet drejtoria përgjegjëse për biodiversitetin për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj

Shtojca 1

FORMATI I MARRËVESHJES PËR TRANSFERIMIN E MATERIALIT GJENETIK NGA BURIMET *EX-SITU*

Kjo marrëveshje lidhet në zbatim të nenit 44/10, pika 4, të ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar.

I. PALËT

1. Ofruesi (mbajtësi i koleksionit ose pronari):

- Emri/institucioni: _____
- NIPT-i/nr. identifikimi: _____
- Adresa dhe kontakti: _____
- Përfaqësuesi ligjor: _____

2. Marrësi (përdoruesi):

- Emri/institucioni: _____
- NIPT-i/nr. identifikimi: _____
- Adresa dhe kontakti: _____
- Përfaqësuesi ligjor: _____

II. OBJEKTI I TRANSFERIMIT

- Përshkrimi i materialit gjenetik: _____
- Lloji/specia dhe kodi unik: _____
- Sasia dhe numri i mostrave: _____
- Burimi *ex-situ* i origjinës: _____
- Të dhënat shoqëruese që transferohen: _____

III. DOKUMENTACIONI I PAJTUESHMËRISË

- Certifikata e aksesit ose certifikata e pajtueshmërisë
e njohur ndërkombëtarisht – numri dhe data: _____
- Pëlqimi paraprak i informuar (PIC) – numri dhe data: _____

OFRUESI	MARRËSI
<u>(emri, mbiemri, firma, vula)</u>	<u>(emri, mbiemri, firma, vula)</u>
Data ____:____:____	Data ____:____:____